

## Termet dhe Kushtet e kampanjës 6% cashback

### 1. Përkufizimet

- a. **Institucioni:** UNIONI FINANCIAR PRISHTINË SHPK.
- b. **Oferta:** Të gjithë klientët e pajisur me kartelën parapaguese Upay Card, kanë të drejtë për 6% të blerjes në rrjetin e marketeve të "VIVA FRESH STORE", nëse kartelën e tyre e rimbushin me mjetet e pranuar përmes shërbimit të Western Union.
- c. **Periudha e ofertës:** Oferta do të fillojë nga data 15 mars 2023 dhe do të zgjasë deri më 20 maj 2023.
- d. **Klient i kualifikuar:** Oferta është e zbatueshme për të gjithë klientët e kartelave parapaguese Upay Card që kanë pranuar mjete përmes shërbimit Western Union.
- e. Çdo klient do të kualifikohet për shfrytëzimin e mjeteve të pranuar nga Western Union, me të cilat ka kryer blerje në "VIVA FRESH STORE".
- f. **Papranueshmëria:** Klientët që kanë pranuar para përmes Western Union, vetëm nga shtetet tjera përveç Kosovës, dhe që rimbushin kartelën e klientit tjetër, nuk kanë të drejtë në cash-back të kësaj kampanje/oferte.

### 2. Detajet e Ofertës

- a. Klienti që ka pranuar para përmes shërbimit të Western Union nga shtetet tjera, me shumën e pranuar ose më pak, dhe kan rimbushur kartelat e tyre Upay, duhet të kryej blerje në marketet e VIVA FRESH STORE.
- b. Për t'u kualifikuar për cash-back, nuk ka kufi minimal të blerjes, dhe blerjet duhet të kryhen gjatë periudhës së ofertës.
- c. Oferta është e zbatueshme nga 15 mars 2023 deri më 20 maj 2023.
- d. Cash-back do të aplikohet në kartelën parapaguese Upay të klientit të kualifikuar, brenda javës pas blerjes së ekzekutuar.
- e. Kjo ofertë nuk mund të shoqërohet me asnjë ofertë/kampanjë tjetër të UNIONI FINANCIAR PRISHTINË SHPK.

### 3. Komunikimi i Ofertës

- a. Oferta do t'u komunikohet klientëve të kualifikuar përmes SMS vetëm në numrin e celularit të klientit.

### 4. Termet dhe Kushtet e Përgjithshme

- a. Kjo është një ofertë ekskluzive e ofruar nga UNIONI FINANCIAR PRISHTINË (në tekstin e mëtejshëm referohet UFP). Të gjitha detajet në lidhje me ofertën janë të disponueshme në të gjitha agjencitë e rrjetit dhe ueb-faqen e internetit ([www.ufp-ks.com](http://www.ufp-ks.com)).
- b. UFP rezervon të drejtën të modifikojë/ndryshojë të gjitha ose ndonjë nga kushtet e zbatueshme për këtë ofertë. UFP gjithashtu rezervon të drejtën për të modifikuar, tërhequr ose ndërprerë ofertën pa caktuar asnjë arsye. As ndonjë gjë që përmban këto terma dhe kushte, as zbatimi i kësaj oferte nuk do të interpretohet si një detyrim i UFP për të vazhduar ofertën deri në një afat tjetër.
- c. Pjesëmarrja në këtë ofertë është tërësisht vullnetare dhe pranohet dhe kuptohet nga pjesëmarrësit se pjesëmarrja do të konsiderohet se është bërë mbi baza vullnetare.
- d. Oferta është e patransferueshme.
- e. Oferta nuk do të jetë e zbatueshme ku është e ndaluar me ligj dhe/ose nuk mund të ekzekutohet për çfarëdo arsye.
- f. Të gjitha mosmarrëveshjet sipas kësaj oferte janë subjekt i juridiksionit ekskluziv të gjykatës kompetente në Prishtinë.
- g. UFP nuk është e detyruar të bëjë ndonjë shpallje publike të rezultateve të ofertës. Klientët e kualifikuar do të informohen nga UFP vetëm përmes SMS.
- h. Në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë ofertë, vendimi i UFP do të jetë përfundimtar dhe detyrues.
- i. Duke marrë pjesë në ofertë, pjesëmarrësit pranojnë të jenë të detyruar nga termat dhe kushtet e përfshira këtu.
- j. Çdo taksë ose detyrim tjetër ose tarifë e pagueshme ndaj qeverisë ose çdo autoriteti/organi tjetër ligjor ose çdo institucion pjesëmarrës, që mund të lindë ose t'i grumbullohet klientit për shkak të ofrimit të ofertës, do të jetë nën përgjegjësinë e klientit.